




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail:zip_gjilan@hotmail.com,tel.0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga seanca e parë (I) e Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më 9.1.2012 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit të vitit 2011,
2. Betimi solemn i anëtarëve të rinj të Kuvendit,
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011,
4. **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 4.1 Propozim plani i punës i Kuvendit të Komunës së Gjiçanit për vitin 2012,
 - 4.2. Propozim-vendimi për orarin e takimeve të Kuvendit dhe komiteteve për vitin 2012,
 - 4.3. Propozim Vendimi për lejimin e këmbimit të pronave komunale me AKP-Rasti "Don Bosko"
 - 4.4. Propozim Plani i veprimt për mobilitet,
 - 4.5. Propozim Plani i veprimt për ndriçim publik,
 - 4.6. Propozim Rregullorja për ndarjen e subvencioneve,
 - 4.7. Propozim Rregullorja mbi procedurat dhe kriteret për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve, Lapidareve dhe Simboleve,
 - 4.8. Informatë:Ecuria e ndërtimit të objekteve shumë banesore,
 - 4.9. Propozim vendimi për lejimin e marrjes së hapësirave mësimore me qira për Studentë,
 - 4.10 Raporti i Komisionit për vlerësimin e aseteve të KRM "Higjiena",
5. Të ndryshme,

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Kryesuesi i Seancës
- Izmi Zeka

Në punimet e Seancës së parë morën pjesë :
Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive

Kryetari i Komunës
Përfaqësuesit e OSB-së
Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
Mediet

Seancën e parë të KK-së për vitin 2012 e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, dy nënkryetarët dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në këtë seancë.

Në vijim të fjalës së tij kryesuesi theksoi se tash nuk do t' i kemi prezent në sallë përfaqësuesit e MPL-së për ta monitoruar seancën, sepse seancat tash e tutje do të përcillen drejtpërdrejtë nga ana e tyre në mënyrë elektronike.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit të vitit 2011,

Sekretaria konstatoi se në sallë janë të pranishëm 39 anëtarë të Kuvendit, kurse mungojnë: Arben Maliqi, kurse një anëtarë nga radhët e PDK-së ende nuk është kooptuar, në Kuvend, sepse anëtari i Kuvendit Riad Rashiti është emëruar në postin e drejtorit për Zhvillim Ekonomik.

Procesverbali nuk pati vërejtje i cili u miratua nga të gjithë anëtarët e Kuvendit

2. Betimi solemn i anëtarëve të rinj të Kuvendit,

Betim solemn e jep anëtari i ri Kuvendit Arianit Sllamniku, kurse për një anëtar nuk ka konfirmim.

3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2011,
Pika 3 e rendit të punës është hequr nga rendi i punës me kërkesë të opozitës për ta shqyrtuar në një seancë të posaçme.

Elisah Ymeri- unë së pari kam vërejtje, sepse raportet po na sillen me vonesë, sepse ne nuk kemi mundësi për t' i lexuar dhe shqyrtuar si duhet. Këto nëse vijnë vetëm sa për formalitet kjo është çështje tjetër, prandaj kërkoj që këto raporte të na i sillini pak më herët në mënyrë që të kemi kohë pak më tepër për t' i analizuar.

Ejup Haziri- unë po e theksoj vetëm një ndryshim në komitete nga ana e PDK-së, do të thotë në Komitetin për Politikë dhe Financa vjen Elisah Ymeri, kurse në Komitetin për Zhvillim Ekonomik, inkorporohet Sabedin Kadriu.

Arben Mehmeti- ne e kemi bërë një kërkesë në emër të LDK-së për disa pika shitesë në kuadër të kësaj seance, të cilën kërkesë e kemi bërë me shkrim, por nuk kemi përgjigje. Kërkoj një sqarim për këtë?

Abdyli Aliu- lidhur me një pikë të rendit të punës të seancës së kaluar pika 3; propozim rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2012 të cilën rregullore parimisht e kemi votuar, por ka mbetur për t' i bërë edhe disa plotësime. Pyetje ime është a janë bërë ato plotësime dhe nëse janë bërë, atëherë kërkojmë që ta dërgohet rregullorja e përmirësuar dhe e plotësuar?

Bahrie Veseli- unë kam një reagim në emër timin, kurse zonjat e tjera le ta vlerësojnë personalisht! Propozimin e anëtarit të rinj në Komitetin për Buxhet dhe Financa, kërkoj nga kryetari i Komunës që ta zbatojë me përpikëri Ligjin për barazi ligjore?

Nuk jemi duke kërkuar lëmosh, por po kërkojmë përfaqësim të drejtë, të dinjitetshëm dhe përfaqësim ligjor. Të gjithë jemi të barabartë edhe para zotit edhe para ligjit, prandaj vetëm po e kërkojmë këtë barabarësi?

Izmi Zeka- kërkesat të cilat i keni bërë janë këto; rregullorja do të vijë e spastruar për të gjithë, sepse jemi pajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ajo rregullore për një kohë të shkurtër do t' i silltë të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Sa i përket kërkesave që i ka bërë LDK-ja edhe ato do të iu sillen me shkrim, por edhe do të jenë edhe në rend të punës në seancën e ardhme, sepse nuk ka asgjë tabu, do të jemi të hapur.

Sa i përket barazisë gjinore edhe ne jemi për ta respektuar këtë çështje dhe vazhdimisht kam kërkuar që vetë partitë ta respektojnë këtë përbërje. Ne më mirë është që t' i rishikojmë komitetet dhe në këtë mënyrë e plotësojmë atë kuotën e barazisë gjinore.

Ky propozim të ndodhin të gjitha partitë politike, prandaj unë po propozoj që ta marrim një vendim sot për t' i rishikuar të gjitha komitetet dhe po i formojmë komitetet ashtu si duhet dhe me matematikë.

Nëse jeni të pajtimit ne të marrim vendim sot dhe sot e përgjithmonë në këtë mandat kjo çështje të marrë fund.

Sokol Haziri- dëshiroj që jap kontributin tim lidhur me këtë pikë e cila është me vend, por realisht sot ne nuk kemi mundësi të vendosim asgjë, por do të ishte mirë që Shërbimi i Kuvendit të na i sjell të dhënat e sakta rreth vijueshmërisë së anëtarëve tanë për ta ditë sa janë të rregullt në këto komitete. Unë plotësisht jam në pajtim që bashkërisht të shikojmë edhe këtë segment të përfaqësimit të barazisë gjinore.

Do të ishte mirë që shefave të grupeve parlamentare t i lehet në dispozicion vijueshmëria dhe përfaqësimi i përbërjes së komiteteve.

Izmi Zeka- ta sqarojmë një çështje për të mos u përmend tërë kohën në KK, barazia gjinore, unë po e jap një propozim: a jeni që të rishikohen komitetet të gjitha dhe të adaptohen me këtë kuotën që po e kërkon?

Saranda Bllaca- këtë nuk jemi duke bërë shaka me fjalë mos ia bani gajlen PDK-së, kujdesin për partinë e juaj, këto nuk janë serioze! Barazinë gjinore e përcakton ligji, nuk është kjo punë e dëshirës, këtu është shumë e qartë gjithçka dhe as kryetari i Komunës nuk duhet të lejojë që të bëhen shkelje të tilla të ligjit. Mos të thuhet asnjëherë nuk dua të dëgjoj për barazi gjinore. Sa herë ta shkelni ligjin për barazi gjinore, ne gjithmonë do të reagojmë!

Izmi Zeka- unë po kërkoj që të marrim një vendim për ta respektuar barazinë gjinore, duke e bërë rishikimin e të gjitha komiteteve? A jeni për atë që ta bëjmë rishikimin?

Ejup Haziri- unë nuk e kam të qartë një çështje? Ne jemi 41 anëtarë të Kuvendit nëse ka ndonjë anëtare nga gjinia femërore që nuk është e përfshirë në ndonjërin prej komiteteve, atëherë unë jam në pajtim që po e shkelim ligjin, por me sa e di unë të gjitha femrat që gjenden në KK, të gjitha janë të angazhuara nëpër trupat ndihmëse.

Mirëpo sa mund ta përcaktojmë për secilin komitet atë 30% nuk është e lehtë për asnjërin prej partive. Këtu është shkelje sikur mos të ishin të sistemuara nëpër komitete, ka vend për

ankesa, por nëse janë të sistemuara në komitete nuk e di për çfarë shkelje ligjore bëhet fjalë?

Sokol Haziri- z. kryesues është koha për ta propozuar për votim dhe ne jemi për këtë vendim që të rishikohen të gjitha komitete, sepse në fakt këshilltaret tona nuk janë të përfaqësuara dhe në këtë rast duhet të ndodhin këto ndërhyrje.

Ne jemi në pajtim që të rishikohen të gjitha komitetet dhe të shqyrtohet edhe puna dhe efikasiteti i tyre.

Izmi Zeka- unë propozoj që të jetë si pikë e parë e rendit të punës rishikimi i komiteteve?

Ju lus që të deklaroheni për këtë rend të punës duke shtuar edhe pikën për rishikim të komiteteve?

Aprovohet rendi i punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit me një pikë shtesë që të bëhet edhe rishikimi i komiteteve duke respektuar barazinë gjinore.

Bahrie Veseli- kjo nuk duhet të ndodh vetëm nëpër komitete dhe mos të thuhet se më nuk dua të bisedohet për këtë çështje! Nuk është kryesuesi i cili e përcakton se a mund të flasim apo jo? Neve ligji na e garanton përqindjen e pjesëmarrjes në forume dhe jo vetëm nëpër komitete, por edhe për të gjitha komisionet të cilat po formohen në Komunë. Nuk po kërkojmë lëmoshë, po kërkojmë të drejtën tonë.

Izmi Zeka- sa herë e kam thënë se ne e menaxhojmë pushtetin, ne nëse e shkelim ligjin, ju keni të drejtë të bëni ankesë në MPL. Nuk duhet të harroni se dikush tjetër banë përgjegjësi për mos funksionim të këtij qyteti.

Ju keni të drejtë ta ngritin zërin të shtunave dhe të deleve dhe në Prokuori ashtu si po e ngritni, por ligjet i dimë edhe ne dhe mos na rrëfeni shumë për ligje!

Do të jem konkret; a jeni që në bazë të ligjit të bëhet edhe përcaktimi për të gjitha komitete në nivel komunal dhe përgjegjësinë e marrin shefat e grupeve të cilët e harmonizojnë përqindjen sa duhet të jenë femra që nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe të tjerët.

Kush është për këtë propozim?

Aprovohet ky propozim me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 2 ishin kundër.

Në vendim të theksohet se në seancën e ardhshme sillen propozimet.

4. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

4.1 Propozim plani i punës i Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2012,

4.2. Propozim-vendimi për orarin e takimeve të Kuvendit dhe komiteteve për vitin 2012,

Sadri Arifi- anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të njohur se është mbajtur një takim diku në muajin dhjetor në të cilin takim është propozuar plani i punës së Kuvendit për të cilin plan kemi qenë gjithëherë në pozitën e parë, kurse këtë vit ka qenë e para Komuna e Vushtrisë, kurse ne do të mbesim të dytët.

Unë kam kërkuar nga drejtorët e drejtorive komunale që t' i paraqesin prioritetet e veta për vitin 2012 në mënyrë që paraprakisht të dimë se çka do të shqyrtojë KK në seancat e ardhme. Me përjashtim të Drejtorisë për Urbanizëm, asaj për Financa dhe asaj për Mbrojtje dhe Shpëtim, të tjerat drejtori nuk i kanë sjellë prioritetet e veta.

Ato që janë i kemi fut në plan të punës, por në plan të punës i kemi inkorporuar edhe çështjet standarde si janë raportet tre mujore, gjashtë mujore, raportin e kryetarit të Komunës,

miratimin e buxhetit etj. Këtë vit është një hap përpara, është një avancim sa i përket transparencës dhe unë besoj që ju mund të debatonit dhe edhe sot mund të propozoni gjëra që mendojnë se mund të futen në planin e punës.

Bashkëngjitur me këtë plan e keni edhe orarin vjetor të takimeve të cilin e kemi vështirë për ta respektuar, por është obligim ligjor që ta aprovojmë edhe njërin edhe tjetrin.

Jakup Bajrami- ne tash u informuam nga sekretaria se disa drejtori nuk i kanë sjell raportet, por unë e kam parë këtë plan pune dhe e kam vërejtë se arsimit nuk ka planifikuar për të dhënë ndonjë raport të punës. Mendoj se kjo është një ndër drejtorit më me rëndësi dhe ka peshë dhe vlerë të madhe, prandaj në një prej takimeve të radhës mendoj se duhet të jetë në korrik ose në fillim të shtatorit të parashihet një raport nga Drejtoria e Arsimit. Mirëpo ka qenë mirë që edhe tash në gjysmë vjetorin e parë të jetë një raport. Kjo ishte vërejtja e ime.

Saranda Bllaca- është mirë që është bërë ky orar dhe nuk është hera e parë që po bëhet, por vërejtje kam te Komiteti i Arsimit, sepse sipas këtij orari nuk është paraparë që në janar dhe në korrik të mbahet nga një mbledhje e këtij komiteti. Në të dy këta muaj është e nevojshme të mbahet nga një mbledhje, por janari ka kaluar dhe nuk është mbajtur asnjë mbledhje në kohën kur përfundon gjysmë vjetori i parë dhe fillon i dyti, por edhe në korrik është e nevojshme, sepse viti përfundon më 20 qershor, kurse në orar është data e mbajtjes së mbledhjes më 5 qershor.

Propozoj që këto data të Komitetit të Arsimit të kenë një lëvizje të vogël, sepse janë të nevojshme, kurse te plani i punës është vendosur raporti 6 mujor i kryetarit të Komunës në korrik dhe të drejtorive në muajin korrik, kurse në anën tjetër në muajin korrik nuk parashihet që të mbahet seancë e KK-së.

Izmi Zeka- ne do ta bëjmë edhe një rishikim duke i pasur parasysh vërejtjet e juaja, sepse jemi të vetëdijshëm se në plan të punës do të mungojë diçka, por edhe do të shtohet diçka, por orientimisht duhet të bazohemi në këtë plan dhe orar.

Kush ka vërejtje le t' i dërgojnë me shkrim për ta bërë një plan dhe orar sa më të mirë.

Ju lus kush është për aprovim të këtyre dy pikave të rendit të punës me këto dy plotësime?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.1 dhe 4.2: Propozim plani i punës i Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2012, dhe Propozim-vendimi për orarin e takimeve të Kuvendit dhe komiteteve për vitin 2012,

4.3. Propozim Vendimi për lejimin e këmbimit të pronave komunale me AKP-rasti "Don Bosko"

Qemajl Mustafa- unë politikisht po e bëj një sqarime, sepse për ndryshe këtu ka qenë desh të jetë zyrtari i pronës, Sali Fazliu, sepse ai i din detalet.

Kjo është një lëndë e cila ka filluar të realizohet dy vite më parë dhe ka pasur shumë pengesa. Këtu është fjala për tokën për rreth ish Shtëpisë së Paqes që e kemi quajtur dikur, përballë Kazermës së FSK-së ose pranë ish Restorantit "Lura". Aty gjendet lokacioni dhe i posedoni të dhënat. Mirëpo për fat të keq ajo prona afër është privatizuar më herët, por një pronë ku sot gjendet Eulexi edhe më tutje ka qenë shoqërore dhe nën ingerencat e AKP-së, një pjesë e asaj prone i ka takuar "Mekanizmit", ndërsa një pjesë tjetër i ka takuar ish Kombinatit Bujqësor "Mlladost".

Këto dy ngastra e di që kanë një sipërfaqe prej 1 hektari e 50 ari, janë propozuar për kompensim me Agjensionin Kosovar të Privatizimit me tokat Komunale në Kodrën e Velekicës dhe të një kodrine në fshatin Nasalë. Vlerësuesi ka dalë pasi që është plotësuar e

tërë norma ligjore dhe dokumentacioni ka shkuar në AKP dhe vlerësuesi ka dalë nga MEF-i dhe para disa muajve e ka bërë atë vlerësim të këtyre pronave në të dy këto fshatra. Ne gjithsejtë për 1.5 hektar tokë i kemi dhënë 15 hektar, do të thotë është raporti 1me 15. Çdo procedurë është mbyll, parcelimet janë kryer, kurse ne këtë vendim e marrim sot për t'ia mundësuar Kadastrit për ta bartë pronën dhe në ndërkohë është duke u hartuar kontrata në AKP të cilën kontratë e nënshkruan kryeshefi Ekzekutiv i AKP-së dhe kryetari i Komunës. Me këtë bartje dhe me këtë kontratë ne i hapim rrugë Qendrës së Investimeve në Qendrën "Don Bosko" Ata nuk investojnë për pa e marrë një vendim nga KK për dhënie në shfrytëzim për kohë të pacaktuar të Qendrës "Don Bosko" këtë tokë. Ai vendim do të merret paralelisht me një informacion paraprak që do të vijë drejtori i Qendrës "Don Bosko" dhe do t'ia jep Kuvendit biznes planin për aktivitet të cilat kjo qendër do t'ia ushtrojë për shumë vite në Komunën e Gjilanit, si qendër socio-kulturore dhe arsimore. Ai do ta jep një raport për planin e biznesit dhe mandej ne do ta marrim një vendim për t'ia dhënë tokën në disponim për shumë vite.

Ky është arsyeimi për këtë propozim-vendim dhe ne sot po vendosim për parcelimin dhe evidentimin e pronave.

Izmi Zeka- këtu ka qenë desh të vijë, zyrtari i pronës Sali Fazliu, por ne i kemi të njohura këto gjëra dhe kryetari i Komunës dhe sqarime të mjaftueshme për këtë propozim vendim.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë të rendit të punës, prandaj kryesuesi kërkon na anëtarët e Kuvendit që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.3: Propozim Vendimi për lejimin e këmbimit të pronave komunale me AKP-në, rasti "Don Bosko

4.4. Propozim Plani i veprimit për mobilitet,

Izmi Zeka- ne këtë pikë pak e kemi debatuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, por këtu e kemi edhe zyrtarin për mobilitet i cili do të na jep sqarime përmes projektorit, por fillimisht fjalën do ta ketë zv/kryetari i Komunës, Omer Daku

Omer Daku-- unë desha t'iu njoftoj se nga kryetari i Komunës si koordinator i grupit punues jam caktuar unë, pas së cilës ka qenë desh të formohet një grup punues.

Mirëpo ky grup punues përbërja e të cilëve me emra ka qenë jo i plotësuar, por me sugjerime se si do të duhej të jetë! Këtu duhet të jetë përfaqësuesi i Drejtorisë për Shërbime Publike, mandej Urbanizmit, Buxhetit, mandej kuadër i jashtëm profesional, shoqërisë civile dhe një zyrtar për informim nga Komuna.

Një përbërje e tillë është formuar e cila ka filluar punën në bashkëpunim me USAID-in gjegjësisht me DEM-in i cili bashkëpunim ka qenë edhe më herët dhe është në vazhdimësi.

Në kuadër të kësaj Komuna e Gjilanit është përcaktuar për dy projekte e të cilat janë: ai për mobilitet dhe për ndriçim publik.

Duhet theksuar se e vetmja është Komuna e Gjilanit e cila është përcaktuar për dy plane të veprimit për dallim nga komunat tjera.

Ne kemi pasur takime me grupin punues dhe e kemi parë të rrugës dhe kemi konstatuar se këtu bëhet fjalë për një plan të veprimit në të cilin duhet dhënë kontribut në aspektin profesional dhe menjëherë kemi filluar me formimin e një nëngrupi punues dhe në atë takim e kemi parë të arsyeshme se duhet të kemi një bashkëpunim të ngushtë me Shkollën e Mesme Teknike .

Ne kemi punuar në kontinuitet kemi pasur shumë takime dhe trajnime në Komunën tonë, por edhe jashtë Komunës. Këto plane janë përgatitur në formë elektronike dhe me anë të

projektorëve të cilat do të keni mundësi t' i shihni drejtpërdrejt se si janë finalizuar, por edhe hapat deri te zhvillimi i këtij plani.

Këtu janë zyrtarët për mobilitet, prandaj edhe ata mund të japin sqarime edhe më profesionale lidhur me këtë plan.

Enver Biçku- unë iu përsëndes të gjithëve dhe fillimisht po theksoj se zv/kryetari e elaboroj formën dhe mënyrën e bashkëpunimit me programin DEMI të USAID-it Amerikan, për hartim të planit të veprimit për përmirësimin shërbimit të transportit dhe mobilitetit në Komunën e Gjilanit. Ne si grup në bashkëpunim me USAID-in e kemi formuar edhe nën grupin punues për mbledhjen e të dhënave dhe shënimeve për hartim të një plani të veprimit që ka pasur nevojë Komuna e Gjilanit.

Në vijim të fjalës së tij z. Biçku theksoi se ky është një material voluminoz të cilin në pika të shkurtra filloi për ta sqaruar para Kuvendit me anët të projektorëve të cilin plan anëtarët e Kuvendin e kanë pasur në material të seancës.

Ramiz Ramadani- unë e falënderoj zyrtarin e shërbimeve publike për sqarime detale dhe personalisht kam fjalë të mira për këtë plan, por ka nevojë për disa plotësime.

Mobiliteti në komunikacion dhe trafiku mendoj se janë çështje më komplekse, jo vetëm në Gjilan, por në tërë Kosovën. Alternativat që janë ofruar në këtë plan për përmirësim të lëvizshmërisë, transportit publik urban, rritjes së sigurisë në komunikacion, përmirësimi i rrethrotullimeve dhe parkingjeve e tjera, patjetër duhet të vlerësohen.

Mirëpo është e pakuptueshme se si ka mundësi që ky plan i një rëndësie jetike për qytetarët e Komunës të mos shqyrtohet nga Këshilli i Ekspertëve dhe Komiteti për Planifikim Urban si dy trupa profesionale dhe të kërkohet që edhe ata ta japin kontributin në këtë drejtim. Përfundimisht mendojmë dhe kërkojmë që të ndërpriten këto praktika të këqija të anashkalimit të komiteteve përkatëse, sepse është obligim ligjor.

LDK do të jetë për miratim të këtij plani duke shpresuar se gjatë fazës së zbatimit këto trupa profesionale, por edhe vet Kuvendi të jenë shumë më të përfshirë.

Gjithashtu kërkojmë që ky grup punues të zgjerohet edhe me përfaqësim politik për shkak të rëndësisë që ka, sepse mendoj që partitë politike kanë obligim që njerëzit e fushave të caktuara që mund të kontribuojnë t' i përfaqësojnë dhe ta japin kontributin në zbatimin e këtij plani.

Jashar Jashari- unë i kam disa vërejtje tek plani i veprimit për trafik dhe për siguri në trafik. Unë nuk pash një plan veprimi për vendbanimin Uglar –Pogragjë. Kjo është një rrugë me një dendësi të madhe të qarkullimit, por edhe me një rrezikshmëri shumë të madhe, sidomos në kohën e dimrit. Unë kërkoj që në disa kthesa të mëdha që i ka kjo rrugë të bëhet një mburojë për të pasur një siguri më madhe të njerëzve dhe trafikut.

Bahrie Veseli – unë propozoj që të bëhet një punë më e mirë dhe të punohet në aksin e shtigjeve për biçikleta, sepse me këto shtigje krijohen kushte më të mira për shkarkim të komunikacionit me automjete, por edhe ndotja e ajrit do të jetë më e vogël.

Duhet pasur pra kujdes për planifikim të shtigjeve për biçikleta, por edhe për njerëzit me nevoja të veçanta. Këto planifikime mundësojnë që ta kemi një mjedis më të sigurt, por edhe më të pastër.

Omer Daku- unë dua ta plotësoj, se u përmend Komiteti për Planifikim Urban që ka qenë desh të debatohet, por theksoj se ky plan i veprimit është debatuar në Komitetin për Shërbime Publike dhe pavarësisht kësaj ne do t' i kemi parasysh edhe të gjitha vërejtjet e juaja. Kjo strategji nuk përfundon me kaq, sepse në faza të veçanta do të ketë edhe debate të tjera në projekte konkrete.

Sa i përket zgjerimit me përfaqësues politik, unë po theksoj se në këtë nëngrup ka edhe individ të subjekteve tjera politike, por ne nuk i kemi shikuar në atë aspekt, sepse ne i kemi shikuar vetëm në atë aspektin profesional. Jam shumë i bindur se plotë njerëz që nuk e kanë idenë se nga cili subjekt politik vijnë, por me rëndësi është që ne i kemi angazhuar të gjitha kuadrot të cilat i kemi pasur në dijeni siç është si në Shkollën Teknike nga e cila shkollë janë përfshirë të gjithë ekspertët.

Kjo strategji do të ketë edhe takime të veçanta në çdo muaj dhe kërkoj nga ju që të na e ofroni nëse keni ndonjë kuadër profesional i cili do të mirëpritet për të dhënë kontributin e tyre profesional.

Mirëpo edhe aksi rrugor Uglar-Pogradje, posa ta sqaroj z. Azem Mujku planifikimin për ndriçim dhe të gjitha planifikimet do t' i bëjmë shumë profesionale dhe të kompletuara, duke përfshirë tërë infrastrukturën duke përfshirë edhe shtigjet për biçikleta dhe duke pasur parasysh edhe nevojat e njerëzve në aftësi të kufizuara.

Në fund po theksoj se duhet falënderuar edhe kontributin e policisë, sepse edhe ata kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në këtë plan të veprimit.

Arben Mehmeti- atë që do ta them është në funksion të asaj që ne jemi marrë vesh në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe ky plan është afat gjatë dhe përfundimi i këtij plani mund të ndodh, krejtësisht në një qeverisje tjetër, prandaj edhe komisioni duhet të jetë i përfaqësuar në aspektin profesional edhe prej subjekteve politike. Ky komision që u përmend janë të përfaqësuar edhe zyrtarët komunal të cilët nuk duhet të dallohen politikisht dhe ky është një projekt serioz i ndihmuar nga USAID-i dhe nëse nuk bëhet edhe një përfaqësim të gjerë edhe politik është jo serioz. Këtë po e them, sepse fusha politike është kryesorja e çdo gjëje që ndodh në implementim. Mandej unë mendoj se i njëjti komision nuk ka mundësi ta kryejë e planin e mobiliteti dhe atë ndriçimit, prandaj kjo është një gabim, sepse Komuna ka edhe zyrtarë të tjerë që mund të merren më profesionalisht, ose thënë shkurt një komision ka qenë desh të merret me një plan dhe një tjetër me planin tjetër. Në këtë rast ky është dyfishim i funksioneve e cila dukuri nuk është në interes për Komunë. Në këtë komision ka njerëz për të cilët thuhet se janë nga shoqëria civile si Nagip Krasniqi, kurse në anën tjetër është në komision për të pranuar mësimdhënës dhe drejtorë, kurse në këtë komision e keni thënë se është nga shoqëria civile. Për mua kjo është jo serioze, prandaj kërkoj që zyrtarisht ky Kuvend të kërkojë nga subjektet politike, sipas fuqisë së tyre politike të jenë të përfshirë të tërë trupat, mandej është detyrë e jona për të përfshirë njerëz profesional.

Kjo të jetë kërkesë serioze dhe të respektohet mendimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, sepse ai vendim është votuar dhe nuk është zbatuar.

Izmi Zeka- ne në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi pajtuar që nga një përfaqësues e dërgojnë subjektet politike, por ju duhet ta shikoni materialin dhe jo njerëzit ! Ne e kemi votuar, por ju i dërgoni emrat, por dërgoni ekspertë dhe ata do të jenë aty.

Qemajl Mustafa- së pari po e them se nuk duhet në këtë mënyrë për të rezonuar asnjëri nga anëtarët e KK-së. Ju e dini se këto dy propozim- strategji do të duhej për të dal nga Drejtoria për Shërbime Publike, me marrje të sugjerimeve nga jashtë nëse drejtoria nuk ka kapacitete të mjaftueshme. Atje ku ka kapacitete dhe traditë të qeverisjes dhe ku ka ngritje profesionale të mjaftueshme, këto dy strategji do të duhej të dalin nga drejtoria.

E kemi në ndihmë USAD-in Amerikan në këtë rast dhe në parim mund të jenë çdo përkrahës dhe donatorë i Komunës i cili ka sugjeruar zgjerim të asaj baze profesionale dhe e kemi zgjeruar me njerëz nga jashtë. Për këto plane duhet të sjellim njerëz të cilët janë të këtyre dy lëmive dhe të cilët janë në gjendje të angazhohen për planin ndriçimit publik dhe mobilitetit. Aty janë 2-3 njerëz siç është Jakup Berisha i cili merret gjatë me sport si

këshillëdhënës për ekipin, pastaj e kemi marrë Nagipin i cili një kohë të gjatë merret me aspektin e elektrikës dhe Besimin, kurse të tjerët të gjithë janë profesionistë të Komunës. Nuk duhet gjithherë t' i shohim gjërat nga prizmi i aspektit politik, sepse politika shpesh prish punë.

Izmi Zeka- ky plan i veprimit ka qenë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa që të rekomandohet për Kuvend, prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për ta aprovuar këtë plan të veprimit?

Para se të votoni po i them se partitë ta dërgojnë nga një ekspert, PDK një LDK një dhe AAK një, por të jenë ekspert.

Kush është për ta aprovuar këtë propozim?

4.4.Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.4 e rendit të pinës:
Propozim Plani i veprimit për mobilitet,

4.5.Propozim Plani i veprimit për ndriçim publik

Azem Mujku- z. Mujku së pari e falënderoj USAID-in Amerikan, programin DEMI për bashkëpunim të sinqertë, por në mënyrë të posaçme z. Agim Salihu i cili ka dhënë udhëzime lidhur me modalitetet e programeve të tjera komunale. Programi DEMI ka qenë financues ideator i këtij programi për t' u hartuar kjo strategji në nivel të Kosovës dhe përmes tij kemi marrë përvoja profesionale nga komunat e tjera. Ne kemi për obligim t' ia bëjmë një falënderim Agimit edhe për mënyrën e modalitetit, por edhe për mënyrën e qasjes serioze.

Në vijim të fjalës së tij edhe z. Mujku para anëtarëve të Kuvendit i dha sqarimet me anë të projektorit lidhur me këtë plan të veprimit për ndriçim publik, të cilin plan anëtarët e Kuvendit e kanë pasur mundësinë për ta lexuar, sepse e posedojnë në materialin e seancës.

Elisah Ymeri- unë desha ta përgëzoj z. Mujkun për këtë raport të përpiktë dhe të përkryer duke uruar që edhe herëve të tjera të i ketë këso raporte.

Raporti është shumë në nivel dhe nuk kam vërejtje.

Bahrie Veseli- edhe unë e falënderoj z. Mujkun për këtë prezantim, por e kam edhe një rekomandim nëse pajtohen edhe të tjerët? Kërkoj që së pari të kenë përparësi për ndriçim rrugët e qytetit dhe të mos shkohet nëpër fshatra për pa u ndriçuar rrugët e qytetit të cilat janë të urbanizuara. Duhet t' i epet përparësi rrugëve urbane të qytetit!

Ramiz Ramadani- edhe unë do ta përkrahi këtë punë që është bërë, sepse ekziston arsyetim për të punuar në këtë drejtim, por është çështje e ekspertëve për ta mat eficiencën se cili sistem është më efikas dhe unë e pash se është aty diku mbi 40% disa sisteme të reja të cilat në tërësi i pranojmë. Mirëpo ajo që kërkojmë është që ndriçimi të jetë uniformë , por edhe u përmend edhe përfaqësimi politik, por aty ku është ky përfaqësim më duket se po jemi më pak të gabuar, sepse kemi raste kur ndriçimi është bërë i pjesshëm.

Për këtë kemi reagime të shumta në terren dhe kërkoj që sa herë të bëhet një pjesë e elektrifikimit së paku të kalon nëpërmes Kuvendit, në mënyrë që mos të lejohet të bëhen këso gabime në terren. Të tjerat gjëra të gjitha i pranojmë.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me këtë pikë të rendit të punës dhe zv/kryesuesi i Kuvendit z. Selim Selim i propozon anëtarëve të Kuvendit që ta aprovonjë këtë plan të veprimit për ndriçim publik.

4.6. Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.5: Propozim Plani i veprimit për ndriçim publik

4.6. Propozim Rregullorja për ndarjen e subvencioneve,

Izmi Zeka- është e njohur se ne e kemi formuar një komision për akte normative i cili sipas rekomandimeve të Kuvendit harton draftet e rregulloreve të ndryshme, të cilat i rekomandohen Kuvendit dhe me plotësime dhe vërejtjeve të anëtarëve të Kuvendit aprovohen.

Unë e kam një bindje se në këto dy rregullore, komisioni ka bërë një punë të mirë, sepse në një mënyrë është normuar diçka e cila ende nuk është paraparë me ligj e sidomos te rregullorja e dytë. Mirëpo arsyetimin për këtë do të na jep zyrtari ligjor, z. H. Matoshi

Hevzi Matoshi- kjo draft-rregullore është hartuar në pajtim me nenin 12 pika c. të Ligjit numër 03/L040 të Vetëqeverisjes lokale, rregullave financiare dhe Udhëzimit financiar 02 mbi shpenzimet e parasë publike, nenin 43 pika 3 të Udhëzimit administrativ 2005/08 të Ministrisë së Financave mbi klasifikimin e shpenzimeve dhe nenit 39 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit.

Gjithashtu duke i pasur parasysh rekomandimet e auditorit të jashtëm se Komuna nuk mund të ofrojë asnjë ndihmë financiare nga paraja publike, për pa i normuar procedurat dhe kriteret për ndarjen e subvencioneve, Komisioni për akte normative i autorizuar nga Kuvendi i Komunës ka hartuar draftin e rregullores për ndarjen e subvencioneve e cila është paraqitur për shqyrtim dhe miratim duke pasur parasysh se janë respektuar të gjitha procedurat paraprake ligjore, duke përfshirë edhe debatin publik i cili është mbajtur më datë 25 janar të vitit 2012 dhe të cilat vërejtje dhe sugjerime janë inkorporuar në këtë rregullore.

Unë mund t'iu njoftoj se me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndarjes së mjeteve të buxhetit të Komunës nga fondi për transfer dhe subvencione për ndihmë momentale personave juridik dhe fizik.

Në vijim të fjalës së tij z. Matoshi vazhdoi për ta sqaruar edhe përmbajtjen e kësaj rregulloreje draftin e së cilës rregullore, anëtarët e Kuvendit e posedojnë në materialin e seancës, por duke kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që nëse kanë vërejtje dhe sugjerime, t'iu paraqesin dhe duke i sugjeruar që me ato vërejtje kjo rregullore të aprovohet.

Sadudin Berisha- lidhur me këtë rregullore, Komisioni për akte normative e ka dhënë kontributin e plotë në këtë drejtim dhe si i tillë mund të miratohet dhe të mbështetet nga grupi i anëtarëve të LDK-së.

Tahir Arifi- edhe unë e kam parë këtë rregullore dhe konsideroj se është mirë kjo që ndodh kështu, sepse kjo fushë nuk ka qenë edhe mjaft e rregulluar me ligj, gjegjësisht kjo mënyrë e ndarjes së subvencioneve. Tani janë paraparë disa mekanizma kontrolli, por mendoj se tek pozicioni ku thuhet se kryetari ka të drejtë të jep subvencione deri në 1 mijë euro, ndonjëherë ne mund të kemi situatë urgjente dhe nuk ka mundësi të kalohen të gjitha procedurat, prandaj është mirë që të lihet hapësirë që kryetari ta ketë atë të drejtë ose të parashihet ndonjë mekanizëm tjetër.

Qemajl Mustafa- është shumë mirë që po debatohet për këtë rregullore, por është edhe kërkesë e Auditorit të Përgjithshëm se duhet rregulluar edhe këtë fushë të shpenzimeve të mjeteve. Këtë po e them, sepse përmes subvencionimit harxhohen disa qindra mijëra euro.

Unë i kam vërejt disa mangësi teknike, por edhe përmbajtjesore të cilat do të duhej edhe njëherë për t'iu riformuluar disa fjali siç është;

Te neni 4 thuhet se çka duhet të deponohet nga një subjekt juridik, por në fund thuhet edhe informatë vjetore mbi qarkullimin financiar, por me më pak rëndësi është për ne qarkullimi financiar për një OJQ ose subjekt juridik se sa aktivitetin të cilin e kryen ajo OJQ, prandaj do të duhej të thuhet : **informatë vjetore mbi aktivitetin dhe qarkullimin financiar**

Te neni 6 pasi që nuk është vëllim i madh i mjeteve, mos të merret Kuvendi, sepse do të ishte humbje e energjisë së Kuvendit që të merret me këto çështje, por t'ia delegojë Komitetit për Politikë dhe Financa me një vendim të posaçëm ose të thuhet sot në rregullore që miratimin që ajo që është jashtë asaj që është kompetencë e kryetarit të Komunës e që sanksionohet me rregullore duhet të merr qëndrim Komiteti për Politikë dhe Financa.

Unë mendoj që për personat fizik duhet së paku të jetë 1200 euro, si kompetencë e kryetarit dhe do të duhej për personat juridik, por edhe fizik prapë për familje së paku të jetë shuma deri në 2 mijë euro. Këtë po e them se ka raste kur një studenti të mirë të cilën dukuri e kam praktikuar dhe i kam dhënë një bursë vjetore prej 1 mijë e 200 eurove e që do të thotë 1 qind euro në muaj, prandaj të jetë ajo në vend të 500 të jetë 1 mijë e 200, kurse për personat juridik së paku të jetë 2 mijë euro, kurse rastet tjera i procedojmë në Komitetin për Politikë dhe Financa. Për mua të mbesin edhe kështu si është propozuar, por mund të thuhet edhe me arsyetim të veçantë, kryetari ka të drejtë për të subvencionuar më tepër, sepse mund të ndodhë ndonjë rast i rëndë dhe duhet të intervenohet shpejtë.

Ne kemi pasur raste të djegies së shtëpive, stallave, serave, prandaj paraqitet nevoja për t' i ndihmuar dikujt më shpejt, por më vonë ai arsyetim vije në komitetin e caktuar, prapë informohemi dhe miratohet. Unë mendoj se kështu duhet të jetë 1200 për persona fizik dhe deri në 2 mijë për persona juridik.

Sadudin Berisha- edhe unë pajtohem me kryetarin që ndihma momentale mund të jetë deri në 1200 euro për persona fizikë dhe 2 mijë për ata juridik, por bartja e kompetencave nga Kuvendi i Komunës në Komitetin për Politik dhe Financa për nxjerrje të vendimit të kësaj natyre nuk e lejon ligji, sepse komiteti vetëm mund të rekomandojë dhe jo të merr vendime. Këtu e kam rezervën, sepse Komiteti për Politik dhe Financa nuk mund të nxjerr vendime të natyrës së tillë.

Qemajl Mustafa- mua nuk po më pengon asgjë që të vijnë këto gjëra në Kuvend, por problemi qëndron aty se do të ketë kërkesa të shumta gjatë vitit dhe do të jetë një punë e mundimshme. Në ligjin për LV thuhet saktë se çka nuk i delegon Kuvendi, Komitetit për Politikë dhe Financa, kurse të tjerat nënkuptohet se Kuvendi me një vendim të veçantë mund t' i delegojë çështje secilit komitet.

Arben Mehmeti- ne si komision me kujdes e kemi analizuar këtë rregullore, por sa i përket asaj për qarkullimin vjetor financiar ne e kemi analizuar jashtëzakonisht mirë dhe në të shumtën e rasteve ne kemi pasur organizata të tilla (OJQ), fiktive për realizim të një qëllimi të caktuar dhe më tutje ajo nuk funksionon. Për këtë arsyeje është më serioze dhe për kryetarin e Komunës dhe Kuvendin nëse e ka një informatë se a ka pasur aktivitet, prandaj edhe unë jam për atë që të jetë edhe aktiviteti. Të shtohet edhe aktiviteti për qarkullimin vjetor financiar e cila kërkesë e nënkupton një seriozitet.

Unë jam për atë që Kuvendit t' i mbesin përgjegjësi për shumën të cilën e kemi planifikuar si komision, sepse është përgjegjësi shtesë e këtij Kuvendi që të kujdeset për shpenzim të shumave materiale, kurse kryetari e ka të drejtën për shpenzime të mjeteve, por për shumën të mëdha është organi më i lartë do të thotë KK.

Ne kemi bërë edhe një padrejtësi, sepse ka qenë desh të parashihet edhe një shumë e caktuar për kryesuesin, sepse kryesuesi është në krye të një organi që është më i larti në Komunë dhe nëse asnjë e drejtë nuk i lejohet për të vepruar në këtë drejtim do të jetë e

pakuptimtë. Ndoshta është mirë të jetë shtesë një shumë e caktuar edhe për kryesuesin, nuk po them sa kryetari, por së paku të jetë një shumë!

Jam për atë që të plotësohet me një shumë të caktuar edhe e drejta e kryesuesit për subvencionim të ndonjë rasti.

Ibish Ibishi- edhe ne si grup i këshilltarëve e mbështesim rregulloren për ndarjen e subvencioneve, por atë që deshëm ta themi e tha paraprakisht Arben Mehmeti, prandaj edhe ne e mbështesim propozimin e Arbenit që të kenë të drejtën edhe kryesuesi i Kuvendit për ndarje të subvencioneve.

Qemajl Mustafa- këtu është fjala prej ditës së rishikimit e tutje, do të thotë Kuvendi i Komunës ka të drejtë një pjesë të atij subvencionimi ta marrim prej Zyrës së kryetarit të Komunës, pak prej arsimit, shëndetësisë e kështu me radhë dhe t'ia ndajmë kryesuesit.

Izmi Zeka- Drejtoria për Buxhet dhe Financa e ka për obligim t' i zbatojë vendimet e Kuvendit dhe nuk e ka për obligim të jep sqarime a mundemi apo jo?

Po e theksoj se Kuvendi Komunal i ka 10 mijë euro, prandaj po paraqitet nevoja që të marrim mjete nga Zyra e Kryetarit të Komunës ose te drejtorit dhe kjo o ndodh për shkak të planifikimit jo të duhur. Për këtë arsye është mirë të jetë një pjesë për Kuvendin, të futet në rregullore dhe çdo gjë përfundon.

Qemajl Mustafa- ne po flasim për mënyrën se si duhet të shpenzohen subvencionet, mënyrën se si duhet të autorizohet ai shpenzim? Mirëpo me propozimet për projekt- buxhet edhe për rishikimin ne mund të merremi vesh me atë çështje.

Në fakt ne të gjitha aktivitetet e Kuvendit i kemi mbuluar prej kodeve të tjera të buxhetit të Komunës. Do të duhej të bëhet një analizë e mirë dhe për të parë se çka i duhet brenda një viti Kuvendit të Komunës dhe të gjitha sektorëve dhe ai buxhet të jetë sa më i saktë.

Arben Mehmeti- unë jam që të konkretizohet kjo, të jetë e drejtë e kryesuesit që deri në 1 mijë euro, maksimalisht t' i ndajë!

Nuhi Nuhiu- është mirë të merren vendime dhe të nxirren rregullore, por gjithmonë koston financiare duhet ta përcillini. Duhet ta dini Ligjin mbi financa, sepse unë nuk guxoj dhe nuk dua ta shkeli Ligjin mbi financa. Ju merrni vendime, por nëse nuk janë në harmoni me Ligjin mbi financa dhe ligjet tjera, unë nuk mund t' i zbatoj.

Sa i përket subvencioneve këtë vit do të ketë problem, sepse buxheti nuk ndërrohet sipas dëshirës sonë.

Unë ia kam tërheq vërejtjen që mos formoni komisione të cilat nuk mund t' i paguajmë, sepse komisionet paguhen vetëm përmes kodit të pagave dhe mëditjeve.

Ju nëse merrni vendime kundër ligjore, unë nuk mund t' i zbatoj, sepse kur të na vije Auditori i jashtëm, unë kam probleme me ata dhe jo ju!

Izmi Zeka- unë kërkoj që të deklaroheni për aprovim të rregullores për subvencione me propozimin e Arben Mehmetit, prandaj kush është për këtë propozim?

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.6 e rendit të punës : Propozim Rregullorja për ndarjen e subvencioneve, me propozimin e anëtarit të Kuvendit, Arben Mehmetit

Izmi Zeka- të deklarohe mi për atë që ka të drejtë Komiteti për Politikë dhe Financa që gjithçka që e autorizon Kuvendi ka të drejtë për të vendos, por që nuk bie ndesh me ligjin. Ne po propozojmë që mbi 2 mijë euro subvencione të vendos Komiteti për Politikë dhe Financa, por në çdo 6 muaj të sillt një raport në Kuvend për të parë se çfarë vendime janë marrë?

Ju lutem deklarohuni se kush është për këtë propozim?

Aprovohet propozimi i kryesuesit me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

4.7. Propozim Rregullorja mbi procedurat dhe kriteret për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve, Lapidareve dhe Simboleve

Izmi Zeka- është një rregullore e cila në parim është e mirë, por duhet theksuar se për këtë çështje ligjet nuk ekzistojnë, sepse po ta kishte rregulluar ligji ne sot nuk do të ishim marrë me këtë rregullore. Unë e kam një kërkesë publike nga lëvizja Vetëvendosje që kjo rregullore të hiqet nga rendi punës.

Unë për opinionin do ta jap një sqarim që edhe Vetëvendosja dhe të gjitha të tjerët si shoqëria civile duhet të na ndihmojë që proceset t' i qojmë përpara, duhet të na ndihmojë që të nxjerrim çdo akt i cili i mungon legjislaturës gjilanase. Ato gjëra të cilat nuk janë të sanksionuara me ligj, ne duhet t' i nxjerrim rregulloret. Ne po e bëjmë rregulloren për interesin e Gjilanit, por e bëjmë edhe për interesin e njëfarë rregulli në vendosjen edhe të shtatoreve edhe të busteve dhe simboleve. Por mos të harrojmë, se ne jemi të interesuar edhe si KK dhe kryetari i Komunës që të gjithë dëshmorëve dhe heronjve t' i gjejmë vendin më meritor, vendim më të mirë të mundshëm, aty ku e meritojnë. Ne e dimë që kontributi i tyre na ka sjell këtu, por edhe një gjë duhet ta dini se janë disa njerëz të cilët janë zgjedhur me votën e qytetarëve dhe ata e kanë të drejtën legjitime për të vendos për rregullat dhe funksiononim e çdo gjëje, por normalisht duke u mbështetur në interesat e qytetarëve të Gjilanit.

Kjo rregullore është një bazament për të ec më tutje dhe asgjë nuk është më shumë, prandaj mos të keq interpretohet në opinion. Ne po bëjmë punën më të mirë të mundshme duke u munduar që të vendosim themele në secilin segment ku nuk ka ligj, prandaj ne po e bëjmë për të qenë institucionale dhe rregullative dhe asgjë tjetër nuk ka. Mos të paragjykojë askush se ne nuk jemi duke vendosur tash shtatore as buste, por as duke hequr, por ne po i vendosim kornizat.

Punën e ka bërë komisioni profesional e cila është një punë mjaft e mirë, por me siguri nga ana e natarëve të Kuvendit do të ketë plotësime dhe në këtë mënyrë tash e kemi një rregull për këto gjëra.

Rashit Sahiti- unë e kam një pyetje për kryesuesin e Kuvendit: prej kur Vetëvendosja qenka pjesë e Kuvendit të Komunës dhe nëse nuk është pjesë e KK-së, kur të hyjnë në Kuvend, atëherë kanë të drejtë të japin propozime për ndërrim të rendit të ditës.

Izmi Zeka- unë e bëra një informatë se është një kërkesë me shkrim nga kjo lëvizje për mos ta aprovuar këtë rregullore.

Qemajl Mustafa- në këtë rregullore ka disa mangësi të cilat po i them në fillim dhe mendoj se në vazhdim debati do të jetë më ndryshe.

Së pari në fillim një nen do të duhej të thuhet; “Kuvendi i Komunës përmes komisionit të përhershëm komunal bën përcaktimin e listës së lokacionit dhe hapësirave për vendosjen e përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve”.

Duhet të thuhet qartë një komision i përhershëm profesional që votohet prej Kuvendit do të duhej të merret me përcaktimin e këtyre lokacioneve i cili komision në fillim ka shumë punë, por më vonë në secilin vit e mandat ka më nga pak punë.

Te neni 1 pasuesi i dytë; nuk menaxhohen përmendoret si është thënë, duhet të pasurohet fjalia dhe të thuhet: “për menaxhimin e procesit të vendosjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve të vendosura në hapësirat publike”

Kriteret për vendosje nën 1 të jetë: “në hapësirat publike të votuara paraprakisht” kjo duhet të thuhet. Ai komision e bën propozimin e listës për lokacion me arsyetim të cilin e bie në Kuvend dhe votohet ajo listë.

“Në hapësirat publike të votuara nga KK paraprakisht mund të vendosen përmendoret, shtatoret, bustet dhe simbolet sipas kriterëve të shënuara më poshtë”.

Në 1.1 të jetë të ketë vlerësim nga këshilli i përhershëm komunal, sepse prapë duhet të ekzistojë një këshill i përhershëm komunal i cili ka përfshirje edhe politike, por duhet pasur kujdes që të dërgohen profesionistë të cilët merren me vlerësimin e meritave të dëshmorëve, heronjve, martirëve, viktimave dhe kontribut dhënësve në secilën fushë të jetës shoqërore dhe profesionale të Komunës. Mandej duhet të ekzistojnë faktet të cilat janë të karakterit historik dhe të vërtetuara për kontribut shoqëror historik, ose arsimor, kulturor dhe profesional. etj.

1.3- te iniciativa; “iniciativa duhet të jetë në harmoni me listën e miratuar të figurave dhe ngjarjeve meritorë”

Ky këshill e miraton listën, prioritetin e trajtimit të figurave dhe të ngjarjeve e të cilat figura mund të jenë nga më të ndryshmet. Kjo iniciativë duhet të jetë për figurat për ngjarjet për brenda listës, përveç figurave dhe ngjarjeve jashtë hapësirës shqiptare, kjo mund të thuhet, por që e vlerëson Kuvendi i Komunës.

Neni 4 mendoj se duhet të hiqet, por aty ku është thënë që ka të drejtë qytetari të fillojë iniciativë do të duhej të shtohet dhe personat juridik dhe organizatat, aty duhet të jetë një nen. Neni 4 pika 3 – duhet të pasurohet fjalia; të bashkëpunojë ngushtë me kryetarin e Komunës, kryesuesin e Kuvendit dhe Ekzekutivin e Komunës”. Duhet të obligohet me rregullore që të bashkëpunohet me krerët e Komunës dhe me ekzekutivin.

Neni 6 te pasuesi i parë duhet të jetë; ‘është e obliguar që të bëjë investimin dhe bashkë investimin, sepse kjo nuk është përmendur askund. Komuna është e obliguar që të bëjë investimin dhe bashkë investimin i cili bashkë investim mund të ndodh me familjarët, shoqatat etj.

Te 1.2 është gabim teknik dhe duhet të jetë “në mbrojtje të ambientit”

1.3 duhet të thuhet : “të njoftojë me shkrim”, pastaj vazhdon fjalia

Te neni 7 t’ i shtohet edhe: Arkivi Komunal ose Rajonal ose organi tjetër i përcaktuar me ligj.

Te neni 8 nuk duhet të jetë kështu; mirëmbajtja dhe mbrojtja janë të kuptueshme në çastin kur ndërtohet një objekt i kësaj natyre, mirëmbajtja dhe mbrojtja merren si obligim me automatizëm si obligim i KK-së. Mirëpo restaurimi duhet të mbetet aty dhe për restaurim duhet të merr vendim KK.

Te neni 9 duhet t’ i shtohet: Komuna dhe MKRS i merr ato nën mbikëqyrje.

Te neni 10 pika 1.2 duhet të jetë; nëse nis (fillon) punë dhe jo kryen punë!

Ju faleminderit këto ishin vërejtjet e mia.

Izmi zeka- kam një vërejtje aty ku thuhet të ketë iniciativë për vendosje të përmendoreve, unë mendoj se iniciativat mund të vijnë me 1 mijë nënshkrime, por jo blanko në të vendosim, mund të ketë iniciativë, por ne pastaj ta debatojmë. Kjo të sqarohet në rregullore.

Sokol Haziri- unë i kam disa vërejtje në përgjithësi përkitazi me mënyrën se si po i qasemi në disa problemeve të caktuara. E para në Komitetin për Politikë dhe Financa, gjërat të cilat aty i debatojmë dhe ato që janë rekomanduar për Kuvend ato t' i trajtojmë. Atë që e paraqitet lidhur me kërkesën e Vetëvendosjes, në si Kuvend nuk kemi nevojë të marrim qëndrime të tilla, kur kjo nuk është debatuar në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Kam bindjen se kur flitet për dëshmorët heronjtë dikush mendon se ato janë pronësi e dikujt dhe ne duhet të hezitohet, çka të bëjmë dhe si të vendosim?

Ata njerëz kanë luftuar për liri demokraci dhe institucione dhe institucioni që duhet të vendos për këto gjëra është ky ku jemi ne. Mandatin tash ne e kemi, pas neve vijnë tjerë dhe kanë tjetër mandat dhe jam i bindur se ne duhet ta respektojmë veten. Kush çfarë kërkesa bën mua nuk më bën përshtypje fare, sepse po merremi me disa gjëra të cilat krejtësisht janë jo tonat, sepse askush nuk ka të drejtë nëse nuk është këtu ne të merremi me ata? Këtë duhet ta dimë të gjithë dhe dua ta sqaroj në emër timin dhe të grupimit tim politik dhe nuk dua absolutisht të punoj nën presion të askujt dhe i ftoj të gjithë që t' i kryejnë punët me ndërgjegje të veta për pa u marrë shumë me ata që flasin rrugëve.

Mandej nuk më pëlqej fare paraqitja e këshilltarit të kryetarit (drejtorit), sepse ai nuk guxon të thotë ju po merrni vendime të paligjshme. Ne marrim vendime që janë obligative për ekzekutivin e Komunës dhe e ftoj kryetarin që t' i disiplinojë paraqitjet e tilla, sepse nuk shkojnë në frymën e asaj që fola më herët. Shumë vendime të Kuvendit nuk po zbatohen dhe kjo është shumë e vërtetë dhe kjo do të duhej të ishte temë e veçantë e këtij Kuvendi dhe jo të na mbajë ligjëratat dikush se kemi të drejtë nuk kemi të drejtë ose kemi kod dhe nuk kemi kod. Është zyra ligjore, është Shërbimi i Kuvendit dhe paraprakisht i marrim sqarimet dhe marrim vendim. Kërkoj që të vendoset një rend dhe institucionet t' i kryejnë punët ashtu siç iu ka hije pa asnjë ndërhyrje dhe mos të bëhet Kuvendi instrument i ekzekutivit dhe i askujt tjetër. Kjo është kërkesa ime faleminderit për durim.

Qemajl Mustafa- së pari po e potencoj se duhet të flasim konkretisht, duhet ta sjellim listën e vendimeve të cilat nuk po zbatohen, atë që e tha Sokoli, sepse kjo është e drejtë dhe obligim i secilit anëtarë të Kuvendit. Nëse kemi arsytim do ta themi, pse nuk po zbatohet ndonjë vendim i Kuvendit, por është edhe obligim i Kuvendit nëse ka pengesa për ta zbatuar një vendim, duhet shfuqizuar atë vendim me një vendim tjetër. Nuk duhet thënë shumë, por duhet parë listën se cilat janë ato vendime të cilat nuk po zbatohen?

Sa i përket vendimeve të Kuvendit jo të gjitha janë perfekt në harmoni me ligjin, prandaj aty qëndron vërejtja e Sokolit për njërin nga drejtorët, por duhet shtuar së paku edhe një gjysmë fjalië ndoshta jo përherë në harmoni me ligjin.

Sa i përket rregullores, unë absolutisht nuk jam i interesuar të flas për ata të cilët nuk janë pjesë e këtij Kuvendi, sepse ata e kanë pasur arenën dhe hapësirën për të dhënë mendime për rregulloren. Kjo rregullore ka filluar të projektohet shumë herët, mandej i ka kaluar të gjitha procedurat, ajo ka qenë 30 ditë në debat publik dhe ka qenë e eksponuar në faqen e Komunës dhe secili individ dhe grupim politik ka pasur të drejtë t' i jap vërejtjet dhe sugjerimet e veta.

Edhe unë iu sugjeroj që të mos merreni me ata që janë të interesuar për të shkaktuar konflikte, për të shkaktuar anarki dhe për të prish rendin dhe harmoninë dhe punën e mirë të Kuvendit të Komunës.

Sokol Haziri- unë nuk thash të gjitha vendimet e Kuvendit, por shumica e vendimeve të Kuvendit janë të paligjshme. Vendimet e Kuvendit duhet të jenë vendime autoritative dhe të zbatueshme dhe nuk duhet të jenë objekt i vlerësimit të ekzekutivit, janë apo nuk janë në përputhje me ligjin, sepse janë instancat tjera të cilat e vlerësojnë ligjshmërinë e një akti të Kuvendit. Unë në seancën e radhës së bashku me opozitën ndoshta do t' i nxjerrim vendimet e Kuvendit të cilat nuk janë zbatuar.

Sabedin Kadriu- sipas asaj që të takon, kryesuesi është ai i cili e ka për obligim për të mbajtur rendin në Kuvend, sepse ne jemi duke debatuar për rregullore dhe për aprovim të vendimeve të ndryshme dhe kur dikush del jashtë rendit të ditës është obligim i kryesuesit që t' ia tërheq vërejtjen atij këshilltari. Kjo është një vërejtje e imja, sepse ne jemi duke debatuar për rregullore, por nëse duam të bisedojmë për vendime, atëherë e vëni në rend të punës dhe bisedojmë për te.

Sipas asaj që u debatua këtu u pa se kjo rregullore është totalisht e papërpunuar mirë, sipas propozimeve që i bëri edhe kryetari i Komunës, prandaj unë propozoj që kjo rregullore të mos votohet sot, por të plotësohet edhe njëherë mirë me të gjitha propozimet, sepse ne jemi mësuar që t' i aprovojmë me këto vëreje, kurse më vonë ato rregullore po na vijnë të paplotësuara. Ata të cilët kanë vërejtje në këto rregullore t' i dërgojnë me shkrim deri në seancën e ardhme dhe kur të vijnë në seancë mund ta ndryshojmë ndonjë fjalë, por jo në të bëhen ndryshime në çdo nen dhe paragraf. Propozimi im është kjo rregullore të debatohet dhe pastaj të aprovohet në seancën e ardhshme.

Sadudin Berisha- ne si anëtarë të grupit të LDK-së e kemi mbështet që në fillim iniciativën e mazhorancës për nxjerrjen e një akti normativ për rregullimin e kësaj fushe të vetëdijshëm se do të duhej Kuvendi i Republikës së Kosovës të nxjerr sa më parë një akt ligjor i cili në mënyrë precize do të rregullonte procedurat edhe mënyrën e ardhjes deri tek një emër ose objekti i cili e përkufizon të kaluarën tonë historike. Ajo nuk ka ndodhur, por zhvillimet kanë qenë të tilla dhe ne kemi vendos shtatore buste, simbole dhe figura historike të kombit duke dashur që t' ia bëjmë një nderim këtyre figurave të spikatura.

Mirëpo në mungesë të një ligji i cili e rregullon këtë fushë do të duhej që një akt i cili nuk mund të bie ndesh me interesat nacionale apo qytetarëve të Komunës së Gjilanit të nxirret deri në ditën e nxjerrjes së një ligji i cili i do të do t' përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e caktuara.

Ne në Komisionin për akte normative, mjaft vështirë e kemi pasur të nxjerrim norma të caktuara se si duhet të jetë kjo, sepse nuk kemi pasur asnjë bazë elementare ligjore për këtë.

Është e vërtetë se i ka kaluar të gjitha procedurat, ka qenë në dëgjim publik, vërejtjet të cilat janë dhënë në atë dëgjim publik të gjitha janë inkorporuar, por është në mangësi te komisioni, sepse epen vërejtjet, mandej pastrimi i tekstit mund të ketë defekte gjuhësore të cilat vërejte i dha edhe kryetari i Komunës. Ne mbështesim këtë iniciativë dhe vërejtjet të cilat i bëri kryetari i Komunës pjesa dërmuese qëndrojnë edhe pse në një mënyrë janë të rregulluara, por vetëm ka të bëjë me iniciativa dhe propozime, ku duhet iniciativa të eliminohet, por sidoqoftë, unë mendoj se pjesa dërmuese e atyre vërejtjeve duhet të inkorporohet.

Unë nuk besoj se kjo do të jetë përfundimtare dhe të do të ishte mirë që Kuvendi i Komunës dhe të gjitha grupimet politike me iniciativën e LDK-së të fillojmë procedurën për miratimin e një ligji për mbulimin e kësaj fushe i cili do t' i adresohet komisionit të ligjeve në Kuvendin e Kosovës si nevojë dhe domosdoshmëri e kohës.

Sami Azemi- edhe 12 vjet pas luftës një rregullore e tillë i ka munguar KK-së, prandaj ne si grupim i AAK-së me të gjitha këto sugjerime dhe vërejtje do ta votojmë këtë rregullore, sepse

kjo rregullore i mundëson komisionit që do të del nga ky Kuvend që të punojë dhe shqyrtojë të gjitha kërkesat që vijnë nga qytetarët dhe shoqatat e ndryshme.
Ne e aprovojmë këtë rregullore me këto vërejtje që u thanë.

Tahir Arifi- u thanë shumë vërejte, por tek nenin 13 të cilin, z. Arifi e citon, por vërejta e tij ishte se pasi që kemi pasur probleme në këtë aspekt, duhet gjetur një formulim që të thuhet në harmoni me familjen me iniciues të tjetër etj, por le ta mendojnë një formulim komisioni.

Izmi Zeka- duhet gjetur një formulim tjetër, jo iniciativa t' i lihet kryetarit të Komunës.
Unë mendoj se duhet të jetë me iniciativën e Këshillit.

Qemajl Mustafa- Ç' vendosja është edhe vendosje, sepse merret një simbol dhe nuk gjuhet, nuk asgjësohet, por ç'vendoset i cili akt është i ndjeshëm në shoqërinë tonë prandaj duhet të thuhet: **“ bëhet vetëm me iniciativë të arsyetuar mirë dhe vendimi në Kuvendin e Komunës merret vetëm pasi që iniciativa t' i ketë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit dhe diskutimit publik”**. Iniciativën mund ta merr një individ

Izmi Zeka – iniciativën ka të drejtë ta marrë, Këshilli të cilën e propozuam, por duke i zbatuar të gjitha procedurat.

Qemajl Mustafa- iniciativa vije në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve, kurse Këshilli është i përhershëm dhe iniciativa mund t' i drejtohet kryetarit të Komunës, kryesuesit të Kuvendit, mundet një drejtorie, por ne e orientojmë në Këshill. Është një këshill i përhershëm që merret me këtë punë.

Këshilli së bashku me kryetarin e Komunës merr vendim preliminar, por ne duhet ta pasurojmë këtë nen, por mos të mbetet me iniciativë të kryetarit të Komunës. Iniciativa e grupit të qytetarëve ose përfaqësimeve vije te Këshilli, pastaj këshilli e procedon në mënyrë të rregullt. Ky këshill komunikon me familjarët nëse ka të bëjë me ata, komunikohet me përfaqësimet që funksionon dhe ekziston dhe që ka të bëjë me atë vlerë.

Arben Mehmeti – me rëndësi është se kjo është rregulluar me një masë të madhe dhe është me rëndësi për Komunën e Gjilanit, sepse për herë të parë i ka hyrë punës për rregullim të këtij problemi dhe këtu pat mjaft propozime, por kjo nuk do të thotë se nuk është bërë mirë kjo rregullore. Do të thotë çdo plotësim dhe vërejtje e plotëson rregulloren, prandaj unë jam për atë që ne ta aprovojmë sot me propozime të kryetarit të cilat ishin plotësisht të arsyeshme dhe le ta bëjnë edhe zyrtare kërkesën për plotësime të cilat u paraqiten në Kuvend, kurse ne mund ta rishqyrtojmë edhe më vonë këtë rregullore kur të jetë nevoja mund ta plotësojmë.

Elisah Ymeri- unë mendoj se kjo rregullore pat anomali të shumta, prej të cilave disa u plotësuan, por është e pamundshme për pa mbet edhe diçka, prandaj unë kërkoj që të rishqyrtohet kjo rregullore në të ardhmen nga grupi i ekspertëve që të harmonizohen mendimet me kryetarin e Komunës dhe të ndryshojë diçka me rëndësi që duhet ndryshuar.

Izmi Zeka- besoj se të gjithë jeni në pajtim se rregullorja është e mirë dhe vërejtjet u dhanë. Të gjitha vërejtjet që u dhanë, po pajtohem që këto vërejtje të dërgohen me shkrim në Komisionin për akte normative. Komisioni i inkorporon në rregullore dhe e përfundojmë punën.

Vërejtjet të dërgohen me shkrim të cilat inkorporohen dhe kështu rregullorja është e plotfuqishme.

Ju lutem kush është për këtë propozim le të deklarohet me ngritje të gishtave.

Aprovohet me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit pika 4.7: Propozim Rregullorja mbi procedurat dhe kriteret për vendosje e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve, Lapidareve dhe Simboleve

4.8. Informatë: Ecuria e ndërtimit të objekteve shumë banesore,

Izmi zeka- kjo pikë është kërkuar në seancën e kaluar për të pasur një arsytim për ta nxjerr një vendim tjetër të cilin nuk kemi inkorporuar te rregullorja për ngarkesa tatime dhe taksa, sepse si hap i parë kemi desh ta dimë se cilat objekte dhe sa prej tyre i kanë kaluar premisat e lejes së ndërtimit dhe cilat janë të paplanifikuara?

Ne kemi desh ta kemi një informatë të cilën do të na jep drejtoresha, kurse ne pastaj do ta nxjerrim një vendim për ato objekte të cilat i kanë tejkaluar lejet urbanistike.

Bahrie Mahmuti-në këtë raport si informacion është procesi i ndërtimeve të objekteve shumë banesore dhe këtu në material i keni të gjitha rastet të cilat komisioni i ka verifikuar në terren. Këtu është pasqyruar pajisja e leje urbanistike, leje ndërtimore si dhe procesi i pagesave në emër të rregullimit të tokës ndërtimore si dhe procesi i punëve të ekzekutuara në terren. Këtu nuk janë të gjitha rastet, por janë ato ndërtimet më kapitale të cilat po zhvillohen në Komunë. Ju të gjitha i keni në material dhe nëse ka paqartësi mund të drejtoheni me pyetje?

Arben Mehmeti- unë në këtë çështje, por ne në përgjithësi kemi kërkuar një informatë të plotë, por drejtoresha e tha që nuk është informata e plotë, sepse në këtë dokumentacion nuk janë të gjitha rastet e përfshira të cilën gjë po e dimë edhe ne, por nuk e kemi të qartë pse nuk janë të përfshira në dokumentacion të gjitha rastet. Ne kemi vërejtje shumë, sepse nga 14 objekte 6 kanë tejkalime, 2 pa pranime teknike dhe mungojnë informata të tjera sa i përket lejeve dhe garancioneve bankare dhe shumë çështje të tjera të cilat janë me rëndësi për këtë Kuvend. Për neve është me rëndësi për ta ditur se a është respektuar Ligji mbi ndërtimin i cili është edhe për Inspeksionin e Komunës, por edhe për Drejtorinë e Urbanizmit.

Në terren gjendja faktike është në kundërshtim flagrant me këto ligje dhe unë dyshoj se janë zbatuar procedurat ligjore. Unë propozoj që kjo të përfshihet në Drejtorinë e Urbanizmit për seancën e radhës dhe aty në ndërkohë ta marrim vendimin për të cilin po pretendojmë.

Izmi Zeka- edhe unë mendoj se ne mund të lëmë këtë çështje për seancën e ardhshme dhe të jetë një raport, por vendimin duhet ta marrim sot. Ne jemi duke e ditur gjendjen reale dhe nëse ai edhe pas dy jave, kur ta mbajmë një seancë të veçantë për raportin e kryetarit nuk do ta ndryshojmë gjendjen. Ne po e dimë se këto i kemi fakte dhe një numër i madh nuk është futur në raport. Mirëpo po kërkojmë që në seancën e radhës, drejtoresha të na i sjell të gjitha informacionet, kurse ne po e nxjerrim vendimin si ka qenë në rregulloren e cila është aprovuar.

Ne e kemi të qartë se ka mbindërtime pa leje, prandaj ta marrim njëherë vendimin.

Riad Rashiti – në propozim rregulloren e cila ka kaluar në seancën e dhjetorit ka qenë e paraparë edhe një pozicion e cila ka pasur të bëjë me objektet kolektive dhe të tjera të cilat kanë bërë tejkalime. Për këtë rast ne në Komitetin për Politikë dhe Financa kemi propozuar që KK ta merr një vendim që për të gjitha objekte të cilat e kanë tejkaluar lejen e planit urbanistik, ato të legalizohen me një pagesë të taksës, baza si është plus dyfishi i taksës ose 300% e taksës normale.

Sokol Haziri- unë kryesisht atë që e tha Arbeni, pajtohem me te, por nuk e di a ka mundësi sot drejtorja përkatëse ta plotësojë sot raportin dhe të sqarojë për çfarë arsyeje nuk janë komplet të dhënat e raportit. Ne jemi pajtuar në komitet që të jenë saktë të gjitha të dhënat dhe për të cilat objekte bëhet fjalë? Mandej kemi kërkuar dhe mendimin profesional të drejtorisë përkatëse për ato objekte se a i plotësojnë apo jo kushtet për t' i legalizuar? Unë jam për ta marrë vendimin, por nëse ka mundësi sot t' i marrim këto të dhëna, nëse jo atëherë konsideroj se nuk ka kushte të merret ky vendim!

Bahrie Mahmuti-unë mund t' iu them se ky është një argument se ka tejkalime në terren, mirëpo ne si drejtori asnjëherë nuk do ta kemi listën e komplet objekteve që kanë tejkalime, sepse ne e dimë për ato që i kemi lëshuar leje, mirëpo disa tejkalime në terren vijnë pas inspektimit që iu është bërë nga Inspeksioni. Ne nuk do të marrim vendim vetëm për këto objekte për të cilat kemi evidencë dhe tejkalime ndoshta do të ketë edhe në të ardhmen dhe ky vendim do t' i përfshin të gjitha tejkalimet.

Ky është një vendim i mirë, sepse qytetari duhet ta dijë se nëse bën tejkalime e pret një ndëshkim i tillë.

Sokol Haziri- unë e di që ka Drejtori të Inspeksionit dhe të Urbanizmit, këto nuk janë oaza të ndara dhe ka komunikim. Ne kemi kërkuar që kjo të harmonizohet dhe të dalim me një listë dhe të na sqarohet sa janë objekte ekzistuese që i kanë tejkaluar përmasat e lejes së ndërtimit. Ne nuk mund ta paragjykojmë se çka do të ndodh, por qëllimi këtij vendimi është ndalimi i gjendjes aktuale urbanistike në qytet.

Do të ishte mirë që kjo materie të përpunohet edhe pak, sepse këtu nuk ka nxitim asgjë.

Izmi Zeka- ne e kemi të qartë që ka tejkalime dhe janë sjellë disa modele që ka tejkalime dhe e dimë që mundësia për rrëzim nuk është e lehtë dhe është akt më ekstrem. Mandej nuk kanë ndalje këto raste, inspeksioni po e bën punën e vet, por ne së paku duhet ta marrim këtë vendim që çdo qytetarë që bën tejkalime do të ndëshkohet. Nëse veprojmë kështu me siguri secili investitor do të ketë kujdes dhe nuk do t' i tejkalojë parametrat?

Ne duhet ta bëjmë një zgjidhje alternative, prandaj unë mendoj se ne duhet ta kalojmë këtë vendim!

Qemajl Mustafa- së pari mund të them se ka tejkalime, sepse është një konstatim se kur është bërë rimatja te ndërtimet kolektive, banesore afariste ka dal që ndonjëri nga afaristet e ka marrë guximin i cili mendoj se e ka dëmtuar interesin e vet me atë guxim për tejkalim.

Unë kam propozuar që nëse dikush ka bërë një tejkalim dhe ende mund të inkorporohet në pëlqimin urbanistik, do të thotë nuk e tejkalon indeksin e shfrytëzimit të hapësirë edhe në vertikale edhe në horizontale ne jemi bërë dorëllirë dhe kemi propozuar që vetëm ta gjobisim dhe ajo gjobë prapë është e ulët. Unë kam propozuar që të jetë 200% mbi vlerën e taksës dhe mendoj se është pak. Mirëpo është shumë më pak se sa të rrënohet te ndonjëri ndonjë kat, por e përsëris nëse ende mund të inkorporohet në normën urbanistike.

Nëse nuk mund të inkorporohet është një dënim shumë më i madh, më mirë është ai vetë ta rrënojë, bile është mirë ai vetë ta rrënojë, sepse edhe në gjykatë shpenzimet i paguan vet.

Unë do ta urdhëroj Kadastrin që të tërë objektin të mos e regjistrojë. Ai objekt kalon dhe bëhet objekt jo formal. Kjo gjë është e njohur në botën shqiptare, nuk mund të hipotekohet banesa dhe lokali dhe nuk mund të përdoret si hipotekë më vonë! Kjo është ajo dhe unë do të jem vetë kritikë dhe më duhet ta kritikoj Drejtorinë e Inspeksionit dhe atë të Urbanizmit, sepse ata nuk e kanë për obligim të kalojnë vetëm njëherë andej dhe të konstatojnë se një

objekt filloi me një bazë të mirë, është me leje, por ata e kanë për detyrë ta bëjnë inspektimin në vazhdimësi.

Arben Mehmeti- ne informatat që i kemi marrë po shihet se lista nuk është e kompletuar dhe prej 14 ndërtimeve të larta 6 kanë tejkalime. Kjo nuk ka ndodhur në të kaluarën dhe kjo është risi në këtë qeverisje, prandaj mos të bëhen krahasime të tilla.

Po është Ligji i ndërtimit i cili e rregullon shumë mirë procedurën e ndërtimit, ky ligj e rregullon edhe çështjen e rrezikimit të trollit ose të rrezikimit të fqinjëve, për të cilat raste nuk kemi informata se a ka drejtoria ndonjë kontroll në këtë drejtim.

Gjithashtu ligji mbi ndërtimin e rregullon edhe çështjen e distancës, mandej të izolimit nga temperatura dhe mbrojtjen kundër vibrimeve dhe çështjeve të tjera e të cilat janë të rëndësishme në ato objekte, por ne nuk kemi ndonjë përgjigje, zyrtare nga drejtoria se çka ka ndodh dhe a i kanë këto informata dhe si kanë vepruar në këtë drejtim?

Po ashtu ne kemi informata se afër këtyre objekteve janë rrezikuar edhe qytetarët (fqinjët) të cilën gjë e sqaron ligji mbi ndërtimin. Po ashtu ligji e parasheh edhe vendosjen e një libri të inspektimeve në ato objekte banesore dhe Inspeksioni ka obligim që të shkojë dhe identifikohet dhe të bëjë konstatimin se a është duke u vepruar konformë ligjit mbi ndërtimin.

Ne këto nuk i kemi në informatë se a janë praktikuar gjatë ndërtimeve të objekteve ?

Ligji i parasheh projektuesit, mbikëqyrësit, revizorët të cilët janë obligime ligjore dhe ne as për këtë nuk kemi informata se këto kompani a i kanë këta ekspertë?

Mandej ligji kërkon për të konstatuar se a zbatohen parimet themelore lidhur me projektet a është projekti ideor, projektin kryesor, projektin zbatues dhe projektin e objektit të zbatuar?

Ligji e rregullon edhe çështjen e lejeve urbanistike konform ligjeve do të thotë a i plotëson raportet e revizorit mbi kualitetin e punimeve?

Neni 36.9 thekson se asnjë objekt nuk mund të fillojë të ndërtohet pa leje ndërtimore, por as këtë drejtoria nuk na e ka sqaruar detalisht. Po ashtu Ligji mbi gjokat, parasheh dënime prej 50 euro deri në 30 mijë euro, prandaj nuk e kam të qartë pse këto gjoka nuk i ka ekzekutuar Inspeksioni? Ndaj këtyre përgjegjësive ligjore nuk mund të ik as Drejtoria e Urbanizmit as ajo e Inspeksionit, prandaj duhet të merret një vendim nga ky Kuvend dhe të plotësohet neglizhenca, pasiviteti dhe jo përgjegjësia e drejtorive të caktuara.

Për derisa nuk i kemi këto informata të qarta të sakta me një raport të drejtorisë se a lejon ligji për të ndërhyrë ne në këtë çështje dhe mos të konsiderohen serioze gjokat që parashihen në ligj nëse bëhen këso lloj tejkalime, mendojmë se është kundër ligjore ne ta marrim një vendim të tillë?

Izmi Zeka- unë propozoj vendimi për gjoka për mbi ndërtimet dhe tejkalimet nga leja ndërtimore që të jetë 200% mbi bazën dhe kjo të rregullohet në rregulloren për taksa, ngarkesa dhe tatime në pronë.

Leonorë Bunjaku – unë e ndiej një obligim moral këtu, sepse këtu ka të bëjë me çështje personale (jo konkretisht me mua), por me vëllanë tim i cili është një afarist mjaft i suksesshëm dhe mjaft serioz. Unë desha ta elaboroj këtë çështje dhe po theksoj se gjer më tani vëllai im i ka paguar 107 mijë euro për objektin e parë, kurse për objektin e dytë i ka pasur 35 mijë euro i ka edhe 18 mijë euro për të cilat e ka sjell garancionin bankar.

Për tejkalim iu është imponuar pasi që projekti iu është dukur i mangët, por si i ka paguar deri më tani edhe atë obligim do ta paguajë edhe atë për tejkalim.

Mirëpo tejkalimi ka ndodhur dhe është në formë të nën kulmit , por e dimë se në atë pjesë përballë atij objekti etazhiteti është lejuar edhe më i lartë se tetë kat dhe njëherë i ka të bëra të gjitha shqyrtimet gjeomekanike. Tash shtohet pyetja në emër të këtyre taksave të paguara, Komuna çka i ka ofruar këtyre ndërtimtarëve ose afaristëve? Dihet se ujin, rrymën, kanalizimin, e ka për obligim, Komuna t' ia ofrojë. Atyre këto gjëra i kanë kushtuar mjaft 35

mijë euro instalimet në rrjetin e KEK-ut, ujësjellësit etj, por as trasimi i rrugës ende nuk ka ndodhur edhe pse është premtuar. Atëherë shtohet pyetja se çka po i ofrojmë ne afaristëve dhe ndërtimtarëve dhe pse të merret në vendim për ndëshkim 300% më i lartë? Ata i qëndrojnë prapa obligimeve, por ndoshta do të ishte më mirë t' i epet vërejtje se sa ndëshkime aq të larta! Inspeksioni është desh me kohë të marrin masa dhe mos të vihet deri tek ky ndëshkim.

Qemajl Mustafa- së pari tejkalmi edhe për të një vetmen centimetër është shkelje e ligjit. Ajo që miratohet në urbanizëm me pëlqim urbanistik me projektin ekzekutues sipas njohurve të mia, pastaj bëhet kalkulimi. Ajo që shkruan në vendimin për lejen ndërtimore prej asaj dite ajo është ligj. Ai që e ka tejkaluar një cm e ka tejkaluar me vullnetin e tij dhe me përgjegjësinë e tij edhe materiale edhe ligjore. Këtu nuk ka falje aspak dhe ai që mendon se ne mundemi të lejojmë tejkalime të kësaj natyre gabon shumë dhe nëse ky Kuvend lejon një gjë të tillë, atëherë lejon një anarki në këto veprime.

Unë iu lus që ta miratoni këtë propozim, sepse kjo është një gjobë e butë për ata të cilët mund të inkorporohet në leje ende. Ata duhet të jenë të lumtur që mund të futen ende në normë urbanistike, sepse e legalizojnë objektin. Atje ku nuk mundet komplet objekti do të jetë ilegal, ai nuk mundet ta bëjë regjistrimin në Kadastër dhe ballafaqohet me rrënimin e atij tejkalmi.

Ramiz Ramadani- ne e kemi një gjendje faktike dhe mendoj që sot e morën një gjysmë raportit ose gjysmë informate, por po e llogaris se e kemi edhe një pjesë të këtyre ndërtimeve ose mbindërtimeve kolektive e që janë edhe ato me tejkalime ose forma të tjera.

Mendoj se kjo gjendje ka ndodhur para syve të Inspeksionit, Drejtorisë së Urbanizmit dhe ne seriozisht duhet të merremi me gjendjen faktike.

Nëse ne e kemi një gjendje faktike të saktë dhe thuhet se kemi 14 ose më tepër tejkalime dhe e kërkojmë një zgjidhje, unë jam për atë që ta gjejmë një zgjidhje e cila do të jetë 200% apo 300%, por të bëhet një zgjidhje për këtë gjendje dhe jo që ky vendim të vlejë edhe për të ardhmen. Mendoj për gjendjen që e kemi sot e akuzojmë një drejtori të caktuar, për një vendim të tillë përgjegjës është Kuvendi.

Elisah Ymeri- unë po them se ne nganjëherë po i tejkalojmë hapësirat e mundshme për të debatuar, sepse disa po e marrin fjalën vetëm për të plotësuar numrin e minutave të tyre.

Unë kam një mendim personal që 200% të shkohet me llogaritje të kostos së investimit se ndoshta po e legalizojmë formën e mbindërtimit dhe kështu të paktën edhe Komuna mbetet e kënaqur edhe investitori mos të mbetet i pakënaqur. Mos t' i japim ne hapësirë investitorit që ai ta ketë edhe pjesën e fitimit, ne mos ta dëmtojmë atë, sepse ajo parafolësja e tha atë formën e investimit të cilëve ne nuk ia ofrojmë asnjë kusht investitorit. Asnjë kusht nuk e ka ai vetëm e fillon objektin dhe investime i bën vet, por në njëfarë forme po e legalizojmë edhe pse kryetari ishte shumë i qartë dhe tha që në situata të veçanta do të rrënohen etj, por kjo 200% mua personalisht më duket e butë. Unë jam për ta rrit edhe pak, për ta llogarit koston e investimit dhe të fitimit dhe kështu është llogaria edhe për Komunë dhe investitor.

Qemajl Mustafa- unë i mbeta borxh zonës Leonorë dhe po theksoj se Komuna e ka investuar ujësjellësin në atë zonë në bashkëpunim me investitorët, mandej e ka riparuar rrugën dhe atje është një projekt prej 700-800 mijë eurove për rrugën e re e cila është një rrugë jashtëzakonisht moderne, është me trotuare dhe ndriçim publik.

Sa i përket trafos, ata e kanë vendos trafon me nguti për shkak, sepse atyre iu është desh për ta funksionalizuar objektin për t' i shit hapësirat. Për ndryshe Komuna e ka për obligim, sepse për atë merret taksa ndërtimore dhe jam i sigurt se Komuna do ta kishte investuar një

trafo të asaj natyre. Kjo nuk është justifikim për të bërë tejkalime dhe Komuna nuk bën kompensime të kësaj natyre nëse dikush investon në një diçka tjetër dhe në anën tjetër t' i bëjë lëshime.

Një komunikim i duhur i tyre ka bërë që ta instalojmë ujësjellësin në kohën e duhur, prandaj komunikoni me Komunën dhe është obligim i yni.

Sa i përket Arbenit i cili tha se tejkalimi është risi e që nuk ka qenë në të kaluarën. Mirëpo në të kaluarën ka pasur tejkalime 100%. Te Palestra e sporteve, zero euro ka në buxhetin e Komunës për atë ndërtesë e cila e ka shëmtuar tërë qytetin dhe është në tërësi pa leje.

Ju shikoni në Urbanizëm dhe atje ka një pëlqim urbanistik dhe pëlqimi nuk është marrë për një ndërtesë të tillë. Te Dheu i Bardhë është saktë një gjendje e tillë, prapa Komunës është një gjendje afërsisht e tillë, në Dardani është gjendja e tillë dhe te Ferizi Petroll është një ndërtesë prapë e tillë. Me këtë po dëshiroj ta informoj Arbenin dhe të tjerët se janë dhjetëra mijëra m² të ndërtuara te ndërtimet kolektive pa pikën e lejes. Për këtë arsye janë periudha të pakrahueshme sa i përket disiplinimit dhe qeverisjes së mirë. A ka të meta, ka gjithmonë të cilat po i debatojmë sot.

Izmi Zeka- unë po e hedh në votim edhe njëherë këtë propozim, por që është në harmoni me rregulloren që është më herët. Të deklaroheni se kush është për këtë propozim?

Anëtarët e Kuvendit përkitazi me këtë vendim votuan kështu ;

Për aprovim të këtij propozim-vendimi votuan 18 anëtarë, kurse kundër këtij propozim – vendim ishin 19 anëtarë.

Qemajl Mustafa- çka nuk është taksë duhet të bindeni se është rrënim, nëse mendon dikush ta kontrabandojë një votë për të qenë kundër vendimit, po iu siguroj se unë nuk do të jem dorëlibër dhe iu kam lutur juve për ta miratuar këtë kompromis, sepse ky është kompromis për investitorin.

Për ndryshe e lëmë ashtu si është, mos e votoni, por do të rrënohen katet iu siguroj.

Izmi Zeka- të deklarohe mi edhe njëherë se kusht për aprovim të këtij vendimi ?

Anëtarët e Kuvendit votuan kështu: për miratim të këtij propozim –vendimi i shihet 18 anëtarë, kurse kundër 19 dhe ky propozim –vendim nuk aprovohet.

4.9. Propozim vendimi për lejimin e marrjes së hapësirave mësimore me qira për studentë,

Izmi Zeka- ju të nderuar këshilltarë e keni vendimin e Kolegjit, por komisioni i propozuar nuk ka bërë negociata të tjera, prandaj unë kërkoj që të aprovohet ky propozim-vendim?

Vendimi të vlejë për tre semestra duke filluar nga ky semestër deri më 1 tetori 2013, kurse çmimi mujor i hapësirës është 8 mijë euro në muaj, sipas propozimit në kontratë.

Ejup Haziri- së pari po e sqaroj se unë kam qenë në takimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në atë komitet ne e kemi autorizuar një komision i cili duhet të figurojë të paktën 3 i kontratës dhe aty janë caktuar tre persona. Aty kanë qenë 3 kandidatë siç janë Arben Maliqi dhe Arben Mehmeti dhe ky komision ka qenë desh të raportojnë sot, sepse atë ditë e kanë marrë për obligim edhe prej kryetari dhe prej komitetit që të shkojnë dhe të bisedojnë me Kolegjin për formën se si do të duket ajo kontratë. Mandej edhe tjetra si ka dalë këtu mendimi si merret është paragjyquese se realisht nuk është desh të figurojë këtu Kolegji Universitar-Gjilani se po e paragjykojmë prej këtu. Ky komision së bashku me kryetarin së paku edhe

njëherë ka qenë desh t' i shikojnë hapësirat tjera që i kanë. Të dihet, se çka ka bërë ky komision, pse nuk kanë vepruar si është propozuar në komitet ?

Elisah Ymeri – unë pajtohem që të merret një hapësirë e tillë, sepse është urgjente dhe humane për studentët e Komunës sonë dhe jashtë saj. Mirëpo ne e kemi edhe Kolegjin “Fama” i cili mund të ketë hapësira dhe mund ta kenë një çmim më të volitshëm.

Mandej e kam një vërejtje, sepse këtu thotë nga e hëna deri të enjten, por nuk e di të shtunën dhe të dielave a mësojnë studentët apo jo? Kjo dot ë duhej të precizohet ?

Mandej kam një pyetje a ka konflikt interesi këtu, sepse unë mendoj se një kryetar i Komisionit është në konflikt interesi këtu? Nëse ka konflikt interesi, unë propozoj që të bëhet ndërrimi dhe në atë komision të jetë edhe një femër.

Sokol Haziri- unë e kam pasur qëndrimin tim edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kemi thënë qartë se kjo është obligim i Qeverisë për ta bërë financimin e Universitetit Publik. Mirëpo për të asaj që është interes i Komunës së Gjilanit dhe studentëve tanë, ne jemi deklaruar që nuk do ta pengojmë aprovimin e një votimi të tillë në Kuvend, por duhet theksuar se ka qenë një komision i propozuar ku kam qenë edhe unë i propozuar, por përfaqësuesi i palës juaj Arben Maliqi nuk ka bërë ndonjë ftesë dhe nuk kemi pasur ndonjë koordinim me të lidhur me këtë çështje. Unë nuk e shoh të arsyeshme që të merremi më me këtë çështje, prandaj propozoj z. kryesues për votim dhe kjo mund të kalojë.

Izmi Zeka- nuk ka debatues të tjerë prandaj kërkoj që të deklaroheni se kush është për aprovim të këtij vendimi?

Aprovohet propozim-vendim i pikës 4.9 me shumicë të votave, kurse një ishte abstenim: Propozim vendimi për lejimin e marrjes së hapësirave mësimore me qira për studentë

Qemajl Mustafa – një gjë nuk është bërë mirë, sepse Elisahu e apostrofoi dike për konflikt të interesit. Konflikti i interesit nuk voton në asnjë proces. Prandaj duhet ç' kyçur edhe Leonorën edhe këtë rast i cili u apostrofua, me ligj është kështu!

Ç' kyçeni prej të dy votimeve, numëroni votat mirë dhe ç' kyçeni.

Izmi Zeka- nuk më është kujtuar në këto çaste, këtu është konflikt interesi

Arben Mehmeti- së pari nuk e kam të qartë se për çfarë konflikti të interesit po thuhet? Absolutisht nuk kam të bëjë unë asgjë me këtë dhe këto janë muhabete pa asnjë logjikë dhe këto janë llafe të rrugëve. Më vjen keq që më duhet për ta përdor këtë gjuhë, sepse disa njerëz merren vetëm me shantazhe dhe etiketime.

Qemajl Mustafa- asgjë nuk ik me një votim, por duhet mbajtur mend një gjë, janë rrëzuar dy presidentë të një shteti me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Çdo vendim që merret i nënshtrohet rishqyrtimeve ligjore dhe interpretimeve, prandaj këto raste janë të dukshme.

Unë propozoj që ai komision ta bëjë punën e vetë dhe unë propozoj që sot të mos merret vendim fare dhe ai komision të deklarohet me shkrim që nuk është në konflikt të interesit me çështjen dhe të shkojnë të negociojnë dhe ta sjellin këtu.

Le të mbetët edhe kështu që ai i pari ka kaluar dhe po e dërgojmë në interpretim ligjor !

Izmi Zeka- këtu të dy vendimet janë në konflikt interesi, por mua nuk më është kujtuar menjëherë, por Zyra ligjore të na jep sqarime se a ka konflikt interesi në një rast kur voton motra për vëlla.

Sabedin Kadriu- unë në një takim e kam thënë se na keni shndërruar në njerëz lodra, tri herë votova dhe ju si kryetari i Komunës ka qenë desh me kohë ta konstatoji konfliktin e interesit edhe për Arbenin edhe për Leonorën. Nuk kemi ardh në Kuvend për ta ngrit dorën sipas qejfeve të kujt do !

Izmi Zeka- po e rikthejmë edhe njëherë vendimin e parë, por të na jep sqarime, Zyra ligjore?

Hevzi Matoshi- z.Matoshi e sqaron se konfliktin e interesit e sqaron mirë neni 38 i Ligjit të cilin e lexon dhe konstaton se në këtë rast ka konflikt të interesit.

Arben Mehmeti- ai bashkëpronari i Kolegjit është dhëndër i imi e që nuk ka të bëjë asgjë me mua dhe nuk është familjar i imi. Mirëpo në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk është caktuar që Arben Mehmeti të jetë në atë komision, por janë caktuar dy anëtarë të opozitës me kryesues prej opozitës Arben Maliqi. Ai nuk i ka bërë ftesë askujt për ta shqyrtuar këtë rast, por unë fare nuk kam qenë në komision, por LDK-ja ka qenë në komision, këtë duhet ta sqaroni.

Izmi Zeka- po shihet mirë që sipas ligjit zonja Leonorë nuk ka të drejtë të votojë dhe vota e saj nuk vlen, prandaj ju lus që të deklaroheni edhe njëherë që të aplikohen gjobot për tejkalime të lejes urbanistike, ashtu si është tekstualisht e shkruar?
Ju lutem kush është për këtë propozim –vendim.

Aprovohet propozim-vendimi që në rast të tejkalimit të lejes urbanistike të aplikohen gjobot ashtu si është në tekst të rregullores me 18 vota të anëtarëve Kuvendit, 14 ishin kundër dhe 6 abstenime

Sokol Haziri- unë nuk e kërkoja fjalën për të votuar ose mos votuar, por AAK, votoi tri herë, u deklaruan votat, kaluam në pikën tjetër dhe kthimi nuk është në përputhje me statutin dhe kjo nuk është serioze, prandaj ju nuk keni nevojë të ngrisni tone dhe të hidhëroheni në opozitën, sepse ne jemi opozitë dhe votojmë sipas dëshirës sonë. Ju i keni problemet e brendshme, prandaj ato zgjidhni vetë.

Izmi Zeka- kush është për aprovim të pikës 4.9: Propozim vendimi për lejimin e marrjes së hapësirave mësimore me qira për studentë,

Aprovohet pika 4.9: Propozim vendimi për lejimin e marrjes së hapësirave mësimore me qira për studentë, me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 5 ishin abstenime

4.10 Raporti i Komisionit për vlerësimin e aseteve të KRM “Higjiena”,

Izmi Zeka- fjalën do ta ketë Arben Mehmeti!

Arben Mehmeti- ne këtë pikë të rendit të punës e kemi debatuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe nuk kemi çka të themi më tepër jashtë asaj që e kemi në raportin zyrtar dhe komisioni e ka bërë një punë të mirë që e ka sjell një raport. Do të ishte mirë që këso raporte të sjellin edhe komisionet e tjera kur ngarkohen me punë konkrete.
Ne jemi për ta aprovuar këtë raport.

Izmi Zeka- kryesuesi propozon që të aprovohet ku raport?

Aprovohet pika 4.10 e rendit të punës: Raporti i Komisionit për vlerësimin e aseteve të KRM “Higjiena”, me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Me këto pika të rendit të punës në ora 14 seanca i përfundoi punimet

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA